



VLORA VLORA!

ALMANAK LETRAR Nr 4

~~31625~~

BIBLIOTEKA E SHTETIT
BOSNIA HERZEGOVINA
BOSNA I HERCEGOVINA
BOSNA I HERZEGOVINA
BOSNA I HERZEGOVINA

42177

VLORA - VLORA!

*Almanak i Rethit Letrar të Shtëpisë së Kulturës
dhe Krijimtarisë Popullore V l o r ë*

(Vit' i II-të Nr. 4)


Redaktor: SH. MUSARAJ

Tirazhi: 2000

formati 60 x 88/16

Stash: 2204-55

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tirana



ISMAIL QEMALI

HALIM XHELO

A T D H E U 1)

Shqipëri e dashur
 Je në robëri
 Jamte buzë plasur
 Se ti s'ke liri.

Un' për Ty do vdes
 I dashur Atdhe
 Gjallë të mos jes
 Ndryshe, pse më ke?

Ngrihu burra trima
 Armikut i bini
 Porsi vetëtima
 Këtu mos e lini.

Shqipëria thrret
 Lirinë kërkon
 Nga nevej e pret
 Mvehtësi dëshron.

Nevej të bashkuar
 Gjith' për një qëllim
 Me flamur në duar
 Vdekje për shpëtim.

Tërbac, 9 Maj 1920

1) Botuar në gazetën «Mbrojtja Kombëtare» të Vlorës Nr. 6. datë 18 Nëndor 1920.

VELI STAF A

(Platonicus)

V L O R È S

Si pasqyrë
Bukurie të fali nana natyrë.
Ledhatime
T'ep kaltërsia, vala t'puth me psherëtime:
E flamuri
Ngjyrë zjarri, gjet në ty mburojë guri.
Mjaft dëshmorë
Zgjodhën pér shtrat vdekje dheun tand, o Vlorë:
Nga lakmia
E pangopun t'duel zot pérherë Shqipnia.
Sa therorë
Harroi djalëria, kujtoi ti Vlorë...

Nervi (Itali) 1937

V L O R È S

(Zani i mbramjes)

Krenare si çupë qi nuse shkon,
Në mes blerimit të pambarim, Vlorë
Me llastim buzëqesh, dhe të kundron
Kanina prej s'nalti, me ullishta kunorë.

Kaltërsi deti, gurgullim ujët t'ngri',
Ledhatim mali; të bukur pérherë
Ke si gjergjef virgjineshë përmbi
Qiellin me hyjz qëndisun si në verë.

Oh! sa fort qeshi Adriatiku at ditë,
Kur me shpejti në te u lkundte nj'ani
E vogël; vala e qetë ty ta afronte...

Ishte në gzym, s'u nginte tue t'soditë
Plaku Qemal, e n'sa dneste si fmi,
Pëlhirën kuq e zi në gjuj adhuronte.

Nandor 1934

PETRO MARKO

ISMAIL QEMALIT¹⁾

(Sonet)

FATOS, burimai që çele po shtohet,
Dhe nuk do shterret jo, bota t'humbasë!
Sa zëri i qiellit — fundi! — të bërtasë
— Drita e djellit mbi dhe të pushohet! —

Vepra e jote, përdita ndriçohet!
Po ti o Burrë, na ike pa gas,
Na le përjetë, po ti le pas
Lirinë, Lirinë që Kombi lëvdohet.

Heshtur ti prehesh mejtuar në varr,
Dhe shqipja e lirë flutron si e marrë,
Vërtitet nga brigjet në fush' e në mal,

Zëmrat shqiptare përvlohen si zjarr!
Pa digjet dhe Vlora, djepi ku u shpall
Idea jot' e shënjt' o Ismail Qemal!

«Ora» 1932

PËRMËNDORJA E VLORËS

Trim arbresh, je ti si hekur
E çelik që rri pa tundur!
Fsheh në sy turmën e vdekur
Që nga vdekja s'është mundur!

Rri Rinia e të sheh,
Po mjerisht ajo s'të njeh!
Dhe pyet — o zëmër ftohur:
— Ç'është ky trim i panjohur?!

1934.

1) Në 20-vjetorin e Shpalljes së Pamvarësisë.

KËNGA E VALËS

— Vlorës —

Lëmo o val' e përkëdhel
At breg që s'ësht i gjallë,
E kur të flësh aty në Skelë
Të shtrihesh n'atë zall,
Këndo një këng' e nanuris
Shumë qet' e mengadalë
Se n'atë tokë flë një fis
Q'u ngrit në shekuj valë
Për nderin e Lirisë...

Të keqen val' o mengadalë
Këndo një këngë lehtë
Të mos dëgjohet gjer në mal,
Se aty n'ullishte fshehtë
Dergjen... — oh, lere mos e nga —
Kujtimi u ka mbet!
...Pra ti o val' këndo, mos që
Se zëmrën e ke det
Dhe gjuhën ligjërim e shkumë,
Sa brigje ke në dorë...
Që kot kërkon të vër' në gjumë
Dhe shpirtin tënd o Vlorë!
Po ah o vënd që lind ç'ka vdes,
Pse hesht mbi varri i gjallë?
Pérherë syri yt do jes
Me llahtari në zall?...

Të keqen val' o mengadalë
Këndo kushtrim të qetë...
Se mos dëgjohet lart në male
Në Arbërin' e shkretë,
Se atje dergjet një jetë...

Lëmo o valë e përkëdhel
Me zëmër, jo me zjarr!
Se bën vaki që vdekja del
E s'hesht brënda në varr,
Kushtrimin tënd o të dëgjojë
Oh, ndërsa vëndi qan —
Ahëre o valë, gjumi mbaroi
Dhe labët kush i mban?!

ALEKS ÇACI

V L O N J A T I P L A K

Vallézonin nér luadhe Nuse, Orë Shqiptare,
Lum' e para që këndonte epopenë kombëtare.
Or' e zez' e Shqipërisë dergjet futur në një shpellë,
Nat' e dimrit dhe thëllimi e kish futur thell' e thellë.

Ishin Orët hirëplotë që këndoja mallimi,
Ardhur rishtaz të këndoja sipër varrit të një trimi.
Tundet varri lehtë-lehtë... hidhet plaku nga gëzimi,
Ish ajo që dëshëronte, dor e tij u bë shpëtimi.

Porsa ndriti rezj' e parë, manushaqja pruri erë,
Lul' e bukur kishte mbirë, sipër varrit kishte lerë.
Avullon një afsh i gjallë, frym' e re po del nga varri
Kur një jet' e re po ngjallet, di të rrojë shqipëtari.

28 Nëndor 1955

ANDREA VARFI

V L O R È S

Nëpër ullinjt e bleruar,
Më ngjan, Vlorë, turtulleshë.
Po pse s'këndon më t'aguar
Ti trimoshja labëreshë?

Buzë detit, këtij prillit,
(Jemi sot në parëverë)
As dhe erë trëndafilit
S'po të ndjej më kësaj herë.

Shoh një çerdhe të ronitur
Përmbi rrapi gjethë-rjepur:
Dhe bilbilat, të nemitur,
Në Beun do jenë tretur!

Vetëm te çati e zbehtë
Po shoh ca haxhilejlekë:
Më kujtojnë ata të shkretë,
Anadollin me zejbekë!...

Po te pusi n'ato hane,
Dëgjoj, Vlorë, këngën labçë:
Ndjej... si shëmben istikame,
Dhe thirrjet «Viva la paçe»!

Vlorë, o ylli ynë i rrallë,
Dhe në heshtje, ti s'hesht kurrë:
Ti sërisht do jesh në ballë,
Do të ngresh dhe gurë e drurë!

Ndjej... po ngrihet kënga labçë
Nga Çipini gjer te Çika:
Ti sërisht «Selam-Musaçë»
Do ta «zësh topin nga gryka!»

Ujë-i Ftohtë, (Vlorë), Prill 1932

NEXHAT HAKIU

S H K È M B I I M

Vlorë, Uji Ftohtë, 1935

Ndën bregoren, buzë detit, qëndron akoma shkëmbi im! Ishte imi, se vetëm unë shkoja përditë për t'u parë me 'të. Askujt nuk i kisha treguar, sepse bëhesha zilijar; po të shihja t'ulur ndonjë tjetër, më dukej sikur do të ma rrëmbente një pjesë të zëmrës sime!...

Shkëmbi ishte bërë shoku im më i ngushtë. Herë në gufën dhe herë në majën e tij, çfletova faqet e para të romaneve, zgjida problemet dhe formulat e kimisë. Te shkëmbi fola për hërrë të parë me vetveten, me valat, me qielin e me detin si pas-qyrë. Zérin e zëmrës shpesh herë ma kishte dëgjuar, mendimet dhe ndjenjat m'i kishte rrëmbyer, por vetëm më dëgjonte dhe nuk m'u përgjegj kurrë!...

Edhe kur vetëtinte e breronte, kur era frynte si e marrë, unë e kujtoja kurdoherë shkëmbin, kudo që të ndodhesha: Në klasë, në — shtrat të konviktit, në sallën e studimit, apo duke ndënjur me shokët e mi, sepse ai qe bërë miku im i pandarë!..

Kur valat gumëzhitnin dhe përplaseshin mbi 'të, kur era e tërbuar vërvhellente rrreth thepave të tia, ai qëndronte kurdoherë kryelartë, i patundur, sepse shekuj e shekuj rëndonin mbi 'të. Pas furtunës më dukesh më i ri, më i lëmuar, më i bukur, pa myshk e leshterikë, duke vezulluar nga rrezet e para të die-lit!..

Nuk duroja dot pa të: e shihja nga maja e bregores, nga oborri i shkollës në pritje të ziles së mësimit, natën kur e ndriçonte hëna, sepse mikun tim të shtrënjtë duhej ta kujtoja e ta shihja edhe sëlargu!...

Kur u ndava për herën e fundit me 'të, mos qeshni, m'u rrëmbushën sytë, një lak më zuri fytin, sepse një pjesë t'ëndrave, të dëshirave të mia e kishte marrë ai, si të vetmin kujtim nga zëmra ime, dhe mua më kishte dhënë si kujtim të vetmen gjë që kishte: frymëzimin për vjershën e parë!...

Shkëmbi im është akoma atje. Ndën bregoren, buzë detit. Edhe atij po i afrohet radha që mbi 'të të skalitet kështjella e ëndrave të mia, sepse Vlora-plakë është përtëritur dhe është bë-rë nuse!...

KUJTIMI I SHKËMBIT

O moj Vlora im' e dashur, o moj Vlora ime plakë
Me katonj e me bashoda, me oxhak' edhe buxhakë,
Me sa mijra malarikë anës detit të palarë,
Po në tym e zjarr e flakë ti gjithmon ke qën' e parë...

Ti, moj Vlor' e Fejzo Xhafer, Vlora trime e Selamit,
Vlor' e Ismail Qemalit, por e pashkës e bajramit,
O moj Vlorë shami-zezë, Vlora ime me duvak,
Bijt' e tu për ty, moj nënë janë dergjur në Budak...

Me ullishtet rreth e rrotull dhe me vreshtat anembanë,
Plot nergjize, manushaqe, që t'i muarën dhe s't'i dhanë,
O moj Vlorë e bekuar, ti foleja e lejlekut,
Ku përzihet harapashi tok me hirën e dybekut!...

O moj Vlora im' e dashur me shtëpi e me kasolle,
Ti që s'korre asnjë herë, veç prashite edhe mbolle,
Vlora ime plot bandilla, plot me vasha e me nuse
Që shkëmbejnë ndonjë fjalë te çekriku nëpër puse.

Po të shoh nga maj' e shkëmbit, buzë-detit plot me vala,
Un me ty, pa zë, fjalosem porsi shkëmbi me stërkala,
Për ty, Vlorë, për atdheun, edhe valat diç më thanë,
Kur shqiponj' e arratisur po vërtitesh mbi Sazan!...

N O N D A B U L K A

NË KRYETRIMEN VLORE

Përmbi shkëmbenj e gurë,
Sa epope u thurë!
Sa herë plumb-dushmani,
Çpoj tej-përtej flamurë!

Çkriu plumbi, Ay s'ra!
M'i fortë nga çdo kalà
Nér fushat e mejdanit,
U ngrit la e më là.

Në shi, furtunë e borë,
Ç'e fortë ish ajo dorë,
Ajo që priu flamurë
Mu në kreshniken Vlorë?

M'e fortë nga çdo dorë
Ajo që priu flamurë,
Flamur që s'jepet kurrë,
Ish zemr' e bardhë borë!

Zemra që lart e ngriti,
Flamurin dykrenorë,
U-bë kalà graniti,
Në kryetrimen Vlorë!

Kurrë s'u dha kalàja,
Nér kreshta, gërxhe, maja,
Prej zëmrash ishte ngritur,
Sokolash faqendritur!

Sot mbi shkëmbenj' e gurë,
Nér fusha e luadhe,
Sa lart e mban flamurë,
Po ajo zemr' e madhe!

FATOS ARAPI

VLORË, 28 NËNDOR 1942 1)

Mjergull. Mjergull. Mjergull.
Lebër. Lebër. Lebër.
Lebërit ecni^r mbi mjergull.
Mjergulla —
mbi shpatulla lebërish.

Nga malet me natë zbresin.
Derdhen poshtë me rrëmbim.
Si mbi male nata e zezë, —
përmbi supe sharqet e zinj.

Mjergull e lebër.
Lebër e mjergull.

Po vimë...

Mbështjellë në sharqe.
Nën sharqe — patickat e shkurtëra.
Nënë sharqe — nagandat me plumbë.
Nën sharqe — torbat me bomba.
Ashtu... Nën sharqe...
A e dini ju çfarë mbajmë?
A e dini ju çfarë sjellim?
Të gjitha! Të gjitha!
Tradhëtitë, pabesitë e Bizantit,
injorancën dallkauke osmane,
hakmarjen e egër shqiptare.
Shkëmbenj varfërie,
shkëmbenj injerimi
mbi të cilët u rrit pop'lli ynë
si lisi tërë gunga.

1) Në kujtim të demonstratës së madhe antifashiste të Vlorës më 28 Nëndor 1942.

Ë dini ju ç'po shtrëngojmë,
nënë sharqe — si paticka të shkurtra?:
dufe lirie të përjetëshme,
etje shekullore për dritë,
shprehjen «Azi për Evropë».
Krisma të thyera kryengritjesh,
bubullima revolucionesh. —
Si patickat shtrëngojmë në dorë, nëpër Vlorë.

II

Nëpër Vlorë armiku lëviz.
Në një heshtje të akullt të frikëshme,
Në një hap të matur, të hekurt.
Sa i ri — aq i vjetër armiku.
Sa i njojur, aq i panjohur.

Nëpër mjergullën e murme — të murme;
Nëpër mjergullën e plumbtë — të plumbta.
Në kollona lëvizin drejt nesh:
skllavëria e egër fashiste,
tradhëtitë feodale kopuke,
në kollona vdekja harbute
gjer në dhëmbë shtrënguar në hekur,
nëpër mjergull,
si një frikë e madhe e hekurt,
gjithë lëviz e ecën drejt nesh.

Që të gjithë ecin përpara.
Dhe përpara një grup studentësh
me flamurin e kuq të lirisë.

Dhe përpara armiku lëviz...

III

Trup me trup te Sheshi Flamurit
u përlleshën ata për flamurin.

Përmbi kokë kondaqe mosketash,
Vetëtima maja bajonetash
Nëpër këmbë përplasje helmetash.
Nëpër këmbë copra xhaketash.
Edhe guna
të çqyera ndër këmbë.

Fjalë tē ngrëna,
tē thyera ndër dhëmbë.
Bredhje urdhrash tē prerë, metalik.
Ndër gurmazë tē fryrë armiqsh,
gishtërinjt e verdhë tē ngrirë,
tē mjerimeve tonë — tē ngulur.

Gishtërinjt e verdhë tē ngrirë
tē revoltave tonë tē shënja,
që i pollën si nëna — lehona,
këto netë ilegale
ndër përdheset me baltë e qerpiç. —

Mbi asfalte — pikat e gjakut bijnë,
përplasen nëpër asfalte.
Dhe si pikat e gjakut po thyen
krenaria armike e fryrë,
tradhëtitë me fytyrë tē mufatur,
orientale, —
plluqka, pa ngjyrë.
Me urrejtjen tonë përzjehen
dhe përplasen asfaltele, thyen.

IV

«Te burgu», «Te burgu!».
Dikush ulurijti: «Te burgu!».
Dhe turma — uturimë e turbullt
thirjesh, sharjesh, goditjesh,
vërshoi nga burgu...

Te burgu — mitralozat e rëndë.
Mbi shpatulla shtëllunga mjergullash: —
mitralozat
dhe vdekja më këmbë.

Dhe turma u step, u zmbraps.
Filloi tē têrhiqesh ashtu...

Ku shkon ju, ku?

Ju s'ngrini dot barrikadë
nëpër magistralet e gjëra.

S'kini që të përbysni
ndër sheshe tramvaje e trena.
Po kini e hidhni përpara
shekuj barkalecë, malarikë;
mendime, meskine të palara,
si çallma të përdorura hoxhallarësh.
Kini... Hidhni ashtu:
shkëmbenj varfërie,
shkëmbenj mjerimi
Dhe me grushtin përpjetë:
Përpara!

Kuptojeni:
Jeni më trima e më të ndershëm,
Kur me grushtin përpjetë
jetës i flisni fjalë të zjarrta revolucionesh:
Përpara!

FERHAT ÇAKERRI

1. — BALLADA E NJEZETËS

Digjet flak' Babica, era barut vjen,
Frym tufan i rreptë, gjethet i rrëmben.
Në kuvënd ësht mbledhur gjithë Labëria,
Komandant mbi trima Selam Salaria.
Njeri heq cigarin, tjetri llullën ndez,
Presin të fillojnë sulmin në mëngjerez.
Presin trimat, presin urdhër për luftim,
Të luftojnë, të derdhin gjakun për çlirim.

Rëndë godit topi, ullint' shtrin përdhe,
Plag' të hap në zëmër ty o mëmëdhe.
Zën e ndizen yjet nëpër fush' e mal,
Qafës së Koçut gjumi i ka dalë.
Nëpërtym Selami hipur mbi dori,
Treqind' e ca Labër rendin prapa ti.
Fluturon Selami, shpërthen si tufan,
Trim-i Salarisë, për Vlor' udhën çan.

Vërvshëllen tufani, armët vringëllijnë,
Digjet qielli i Vlorës, deti huturin.
Por nuk pyesin trimat, hidhen përmbi ta
Udhëheqës kanë një Selam Musa.
— Bini luftëtarë, fort me jatagan,
Udhën për një Vlorë shpata po e çan.
Tok me suferinën plumbi po rrëshqet,
Hasmit ju zu gryka, topi tani hesht.

Po tej nëpër qafa, trimat e gjakosur,
Shpirtin nëpër dhëmbë, jetën më të sosur.
Hodhën syt' mbi Vlorën, shqipja po valon,
Buzëqeshin trimat: Vlora po fiton,
Vlor' e Shqipërisë, Vlor' e jataganit,
Për lirin' e shënjtë, gjak i dha vatanit.—

2. — PËR TY ATDHE

E dua jetën, fushën që bleron
Dhe vashën sy ulli, vjollcën plot erë.
Për ty atdhe veç zëmra më këndon,
Gëzim për ty un' ndjej në shpirt çdo herë.
Për ty un thur të parën poezi,
Për ty atdhe dhe jetën e bëj fli.-

DITA E FITORES

— Djali dhe nëna —

(Balladë)

Djali :

A të kujtohet nat' e gushtit
Kur ti më nise partizan...?
Për mua ti aher nuk qave,
Po sot, o nënë, pse po qan...?

Në syt e tu shoh pika lot,
Apo ty ndofta nga gjëzimi
Të dridhet zëmra dhe s'mban dot
Që dhe për ne çeli agimi?...

Nëna :

Po qaj, o bër, se për lirinë,
Kaq djem s'u kthyen në vatan;
I mori era me suferinë
Atje në shtigjet partizan...

Djali :

I ndjen, nëno, zërat gazmorë?
Për popull gjithë muzika bije,
Këta jan tinguj pranverorë
I mblohdhëm ne në mal' e pyje...

U HAP DHE NJË THEMEL

U hap dhe një themel
Në qosh' të lagjes s'onë,
S'u ther atje kurban,
U derth atje beton.

E ngriti trupin lart
Pallati përmbi dhe,
Një hap drejt socjalizmit,
Në lagjen ton' të re

Minares ia kaloj
Selvia mbet në balt
I bukur lartësohet
Për neve ky pallat.

D U R O M U S T A F A J

P A R T I A

Në qoftëse buzë varrit, shtritur
Përmallshëm do flas për atdhenë...
Për njerzit, për tokën e ndritur:

Nuk është gjuha ime që flet
As zëmra që flakë lëshon;
Partia me frymën e vet
Në dejet e mijë jeton.

FETI RRAPAJ

TE VARRI I ISMAIL QEMALIT MË «28 NËNTOR»

Fest' e madhe e Shqipërisë,
Këtë dit' nëndori,
Kumbojn' këngët e lirisë,
Kremton sot arborri.

Po më tepër se çdo vënt,
Po buçet kjo Vlora,
Seç' po shkojn' te varri shënjtë,
Flamur' e kurora.

Sa shum' Vlora është stolisur,
Me dafina mali,
Veç nga ti o plak i ndritur,
Ismail Qemali.

Se në kohën e rrezikut,
Rreth' e rreth taborre
Ngrite lart në mes t'armikut
Shqipen dykrenore.

C'monument për bukurin,
Po të ngrë Partia
Me një dipllomat si ti,
Mburret Shqipëria.

KUJTIM HOXHA

V J E S H T È S:

Serisht gjethet e pemëve
Mbi tokë shtruan të verdhin qilim,
Për vëndin tim vjeshta shpesh her'
Pranver' ka qenë.
Pranver' e madhe lavdi plote,
Pranver' lirije plot shkëlqim.
...Sivjet të presim vjesht' e tretë,
Me krenari, me ballin lart,
Ti do t'a gjësh Atdheun tim
Më mir' se kur një barikat.
Ti në mes nesh, në mes gëzimit,
Do gjësh Skënderin, Ismailin,
Do gjësh Selamin dhe Avninë,
Do gjësh Perlatin dhe Alinë,
Të gjithë me ne do kuvendojnë,
Në Vlorën tonë çati blu.
Jo, ne s'harrojmë
Sa gjak ësht' derdhur dje këtu.
Sërisht gjethet e pemëve
Mbi tokë shtruan të verdhin qilim,
Por me ç'gëzim e presim ne
Vjeshtën e ré.
Bota e tërë le t'a marrë vesh
Se si gëzon kushdo që sot ësht' në shtepi.
Ne në Shqipëri.
S'e presim jo me lot e vaj
Të tretën vjeshtë.
O mirse vjen o vjesht' e tretë
O vjesht' e bukur shqiptare,
O vjesht fitoresh legjendare!

ÇFLETOJ ALBUMIN

Çfletoj, sonde, në dhomëzën time,
Albumin e kujtimeve,
Të vëndit tim të math,
Të vëndit tim të vogël,
E mbushem gjithë gaz e krenari.
O Shqipëri, o Shqipëri,
O nënë trimash sy patrëmbur,
Un' biri yt, për Ty, dua një këngë,
Një këng' të madhe të qendis,
Siç ka qendisur bij' e robëruar,
Më t'bukurën shqiponjë,
Me më t'bukurin mëndafsh të kuq!
Çfletoj, sonde, në dhomëzën time
Albumin e kujtimeve
Të vëndit tim...
Sa faqe të përgjakura zë në album
Qyteti im i dashur buzë detit,
Kjo kull' e lartë ngjyrë hiri
E shqipëris' kështjellë.
Vlorë, Vlorë,
Në festën tënde të madhe,
Në t'madhen fest' të vëndit tim,
Do të të shoh porsi një vajz' të virgjër.
O Vlor' e thinjur,
Më lejo të të puth në flokët e argjënda
Të valëve të detit që kreh era,
Më lejo të të puth në faqet e kuqe
Të zambakëve që çelin rrugës skelës,
Më lejo të të puth plagët e tua
Në bregoret me ullinjtë e mocëm,
Te Xhamia ku Teli dha jetën,
Në shtëpinë ku Mumini u vra!
Më lejo,
Më lejo të puth tokën e ngrohtë
Të Qafës së Koçiut,

Atë që Selam Salaria
Vaditi me gjakun e tij!
Më lejo të puth vëndin ku Ismaili,
Mbas pesë shekujsh shpalli lirinë,
Lirinë tënde, lirinë Shqiptare,
Që ti e ruajte në shpirt
Siç ruan vajza të parën dashuri!
Më lejo të bashkohem me gazin tënd,
Me gazin e bijve të tu trima.
Me gazin e Shqipërisë sonë,
Që lulëzon, që lulëzon...

MILIANO STEFA

NË PRAG TË ROBERISE

Gjashtë prilli i vitit 1939

Atdheu në pragun e pushtimit të huaj;
Ngashërehet atdheu — rrudh ballin e lodhur.
Mbledh grushtat dhe hesht.

E nesërmja shqetëson zëmrat e shqiptarëve:

— Vall çdo t'i ndodhë atdheut...?

— Vall çdo të sjellë e nesërmja...?

Në rrugët kanë dalë djemt e varfërisë.

Djemt e pa rritur pëshpërisin fjalë:

— Punët s'janë mirë...!

Në Krastë¹⁾ ka pushkë...!

— E di... Mbreti po ikën...

— Më mirë, le të vejë në dreq...

Nënënat me lloz kanatat mbyllin nga brënda:

Le të mos futet në to robërija e madhe;

Dhe derdhin lotë nënënat, prisin pranverën;

E humbi rrugën pranvera.

Ishin pregetitur nënënat të martonin djemtë

Me më të bukurat e lagjes...

Do të bëheshin dasma... s'u bënë...

Atdheu pregetej për dasmën e madhe të lirisë...

NËN FASHIZËM

Netët me duar shtyjnë njëra tjetrën,

Netët Shqiptare,

Të lodhura shumë nën armikun e egër...

1) Krastë — fshat në rrëthin e Elbasanit, ku ishin vendosur gazermat
dhe komanda ushtarake e ushtërisë zogiste.

Pas grilash të myllura me fytyrë të zymtë
Humbën zërin netët;
Nuk i ndezën më yjet
Netët shqiptare nën' patrullat e huaja
Njëra tjetrën shtyjnë
Dhe me agimet shkëmbehen...

LIRI E POPULLIT

Tani e themi hapur: edhe naivë ishim,
Shumë gjëra në botë nuk i kuptionim mirë,
Librave të vërteta nuk ua dinim gjuhën;
Po drejt kuptuam gjuhën e dhimbjes së popullit
Kur atëhere na thirri:
Në male partizanë...!
Gjuhën e varreve të moçëm:
Në male partizanë...!
Gjuhën e motrës së vogël
S h p ë t o m ë n i ...!
Gjuhën e nënës kur na dha pushkën në heshtje.
Të gjitha këto ne i kuptuam shumë mirë
Vdekje fashizmit shokë...
Liri e popullit shokë...

M A R O P A S H O

PLAKUT VLONJAT «ISMAIL QEMALI»

«...Do dojë se s'është punë
Eshtë imja Shqipëria
Sazan e Karaburunë
Janë vatanet e mijë».

(E Popullit)

I

Shqipëri, kur terr i natës
Si një darë të shtrëngonte,
Ti thërrite bijtë e besës,
Se agimi po vononte!

T'i thërrite bijt e Shqipes
Luftëtarë me dovletin,
Që në zërin e nënokes
Ndjen ushtimën e rrëmetit.

Ata s'ndënjen, po u hodhën
Tek ish flaka më e zjarrtë,
Tek ish drita më e ndezur
Tek ish drita më e qartë.

Dhe zhuritën nëpër flakë
Zëmra, ndjenja, éndërrime,
Ushëtuan malet tonë,
Këngë hajduçe, këngë trime.

II

Në thinjat e tua rëndonin vjetët,
Në rrudhat e tua rëndonin mendimet,
Dhe sytë e shkëlqyer, sytë plotë jetë
Të qarta që larg shikonin agimet.
Të priste Shqipria, të priste vatani,
Të prisnin ty zëmrat me mall të zhuritur,
Të priste, ty Shqipe, vëlla Shqipëtari,
Dhe kush nuk të priste? Sa shumë të kan' pritur!
Ja dor' e rrudhur po ngrë një bajrak
Dhe era valviti n'ajër flamurin.
C'paloset ai dhe derdhet si gjak,
Mos vallë po loton sot syri i burrit?
Sa vjet ky flamur në zëmra jetoi
Dhe as nuk u shua dhe as nuk u tret,
Po loti dhe gjaku më shumë zbukuroi
Atë dhe Shqipen e fortë me fletë.-

III

Shqipëri ke lindur trima,
Që s'të lënë vetëm kurrë,
Flenë të qetë në vetëtim,
Dhe nën kokë pushkë e gurë.
Bëni provë e thirri prapë
Po s't'u gjëndën Shqipe mali
Shqipe m'u në gurë të thatë,
Zëmër trimi, sy luani.

FERIAT BOCAJ

N A T Ě · V L O N J A T Ě

Flënë si binjakë të katër horizontet,
Sazani puth rëtë
Në det,
Një varkë nxin
Si njollë mbi qilim,
Si në ekran më del qyteti im lindor,
Me pushk' e kazmë në dorë
Me kominoshet nxirë pis,
Me duart rrudha-rrudha
E djersa si Shushica plakë.
Endërroj-ëndërroj
Si ishte Vlora dje?
Plakë mes rrugëve t'Evropës
Ku njerzit skërmitschin dhëmbët me të
E djemtë, fletët e saj, me pushkë nëpër male
U fejuan.
Kënduan këngën e lirisë,
Nuk kishin arsenale,
Armiqve ua muarr.
Në Drashovicë, Kuç e në Shushicë,
Varret ua bëm me armët e tyre,
Lirin e fituam me armët e tyre.

II

Në det një varkë nxin,
E hëna mbleth vetullat,
Nga tymi i fabrikave
Dhe si binjakë horizontet
Supet shkundin nga nata sterri.
U gdhi edhe një natë,

Jo natë idilesh qetsie pa re,
Natë zhurmë motorrash.
Mirëmëngjes qyteti im,
Mirëmëngjes!
U hapën kanatat e dritareve,
E djelli mysafir i largët
Përshëndet plakat qind-vjeçare
Që mbajnë nipat e bijve që ngrënë socjalizmin.
Mirëmëngjes qyteti im, mirëmëngjes!
S'është punë e lehtë të ngrësh socjalizmin,
Do mund, djersë, gjak.
Si qën të ngordhur e shtrimë varfërinë,
Nishan s'ka varfëria,
Dhe neper trotuarët me pemë si roje paradash,
krenar kalon gëzimi,
Me kapardinë e shall nailon
Këndon
Këngën e bijve komunistë që ran në fushën e nderit.

III

Tek ne sejcili ngrë t'arthmen
Me duar të çelnikta.
Tek ne sejcili i vë një gur socjalizmit.
Udhë të mbarë qyteti im, udhë të mbarë!

HAMZA KOÇIU

S T U H I E D E T I T

I rrafshët deti, fushë duket,
Kur dallgë s'ka në hapësirë,
Veç mjegull tretet edhe zhdukët,
Lundron anija gjith' e lirë!

Po kur shpërthen e fryr e marrë,
Stuhì e detit për një ças,
Pulbardhat ngrihen palë-palë
Tallazi çohet mbi tallaz,

E fortë ësht' o miq stuhia,
Çdo send e mbyt dhe e përlan
Por veç lundron, rrëshqet anija
Dhe i del detit an-e-mban'.

K È N D O N D E T A R I

Kish rënë nat' e plot' e errtë,
Mbi detn' e qetë, pambarim.
Lundron anija, mbi kuvertë
Këndon detari me gjëzim.
Këndon për brigjet e Shqiprisë,
Për malet, fushat me blerime:
«O vëndi im, pjell' e lirisë,
Dëgjoma sot ti këngën time.»
Dhe kënga retë seç i çan,
Nxjerr diskun hëna ziliqare,
Përhapet kënga an' e mbanë,
Mbi tokn' e virgjër shqiptare.
Këndon detari çapkën-djalë,

Dhe gjurmat mjegulla humbet,
Anija shkor shigjet mbi valë,
Ndrit një fener tej në bregdet.
Atje kumbim' i këngës tretet,
Ku portokajt çelin plot erë,
Dhe fllad' i qetë lëmon gjethet,
Në muzg të netve çdo prendverë.
Këndon detari për burimet,
Dhe për korijet me lajthi,
Dhe ja: sërih i tret mendimet,
Tej sfondit, mëmës SHQIPËRI.
Këndon: «I bukur je atdhe,
Ke liqej ujë-qelibar,
Alpe me shkurre plot më ke,
Pyje me bush margaritâr.
Ke pllaja ku natyra mbjell
Çaj që plot' erë kundërmon,
Edhe shkëmbenj', thikë nën' diell,
Ku veç shqiponja fluturon.»
Këndon detari i malluar,
Kënga me qef vëndin shëtit
Puth zallet vala diku shtruar,
Mushtari-qor xixat venit.
Këndon detari dhe anija,
Rrëshqet mbi valët me vërtik
Dhe pushton lehtë melodja,
Thinjakun-ar Adriatik.

QESH VALA DETARE

Qesh vala detare
Shkumbëzon e shket,
Brigjet s'duken fare
Veç qiell e det.
Dhe në mugëtirë,
Jupiteri ndrin,
Pa valëz e lirë,
Shkëlqen, farfurin.
Tej shkëlqen ylberi,
Bojëz pelikan
Hëna vrapon t'erret,
Yjtë i përlan.

Horizontit hapët
Këng' e çajkës ndihet
Dhe shqipja detare,
Mbi shkëmbënj po krihet.
Fari ngjyrë gjelbër,
Pérhap rreze, ndrit,
Veç një yll i verbër
Fiket në zenit.
Lundron një anije
Valëve humbet,
Brigjet s'duken fare
Veç quell e det!

QË KURRË MOS SHKELET BREGU YN' I LIRE!

Yjet krye-ulur, sa ëmbël sodisin,
Si pasqyrë detin seç e llamburisin.
Kurse harmonika.... diku seç ja thotë,
Ç'i derdh projektori sinjalet si lotë.
Tej duket Sazani, posi qafë-kali
Në direk t'anijes pulëbardha ndali.
Vrojton me detarët ajo n'hapësirë
Që kurrë mos shkelet bregu yn'i lirë.
Këndon me qef bir' i PARTISË,
Drejton amijen me guxim.
O Shqipëri pjell' e lirisë,
Për ty bën rojë detari trim!

B U Ç I T F A N F A R E

Buçit fanfarë ti pa mort,
Pas hapid luftarak.
Marshojn' detarët dhe më fort,
Liria vlon në gjak.

Lundron anija... tej rrëshqet
Mes valve qelibar
Buçit, fanfar' e nëpër det
Pérhapi tingujt zjarr.

Me ty fanfarë po këndon
Dhe çajka në direk,
Me pun' e bukurjeta vlon
Në t'lirin, — tonin breg.

Ky breg qëndron porsi granit,
E mposht çdo lloj stuhi
Buçit fanfarë, qartë ndrit
Ky diell mbi Shqipëri!

PIRRO STEFA

FJALË PËR VEHTE E PËR TË GJITHË

Jetën e plogët un' e përbuz
Jetën e qetë gjith' apatë;
Fatin e murgut kurrë s'e lus,
S'dua mëshirë nga as njeri;

S'dua të bëhem loj e një fati
Fatin njeriu vet' e farkon,
Dua te matem porsi Ikari.
Djellit t'i qasem tek flakëron.

S'dua te dridhem si një purtekë,
Para furtunës s'egër me shi.
Kurr s'e kam dashur un' atë jetë,
Frikën s'e njoh qysh në të ri

Jetën e dua, tepër e dua,
Me dashuri t'egër, pamasë,
Jeta e shtrënjtë është për mua
Jetës i téri un' i përkas.

Dua të rroj. Dhe atëherë,
Kur të më thonë «S'mund të jetosh!»
Un' do t'u thom: «qënki të mjerë,
Edhe mbas vdekjes mund të jetosh!»

S'dua si bollë unë të jem
Rrugve të hijem, zvarrë më kot.
Krah' të çelniktë dua të kem
Muskuj prej tigri që s'e mposht dot

Dua të rroj dhe atëherë,
Kur më godasin ujrat pa rresht,
Edhe kur nata nxin si humnerë
Edhe kur gjethet bjen për çdo vjeshtë.

S'dua mbas vdekjes shpejt të harrohem
S'dua të thonë: «S'dijti të rrojë!»
Po nëpër njerëz un' të kujtohem,
Bashkë me ta prap të jetoj.

Prapë të marr' pjes' në gëzime
Edhe në brengë bashkë me ta.
Dhe kur të bjenë në ëndërrime
Të më kujtojnë përgjithçka.

Un' dashuroj erërat e ftohta,
Po edhe flladin kur përkëdhel;
Lulet e njoma, netve të ngrohta
Edhe flok artën hënë kur del.

Mëndjen dhe zëmrën, vëndit të shënjtë,
Dua t'ja fal plot dashuri,
Ç'gjë më të bukur e më të shtrënjtë
Ruaj prej kohësh thellë në gjii.

Këngë motorësh dua të ndjej
Këngë gazmore, këngë plot jetë.
Po dhe kitarën mbrëmjes pëlqej
Miken sy kaltërt, puthjen e nxeh të.

Un' adhuroj trimat që dhanë
Jetën e tyre për mëmëdhe.
S'desha fat tjetër në këtë dhe,
Veç Fatn' e shokëve asganë!

T'arthmen e ndritur t'atdheut tim
Un' e shikoj qartë tanë,
Shoh komunizmin plot vezullim
Dritën e jetës plot lumturi.

BEQIR VELO *)

A T O D I T E

Në muajin Shtator të vitit 1912 u dha urdhëri për të mbledhur ushtarë rezervë. Shkuam ne Kalem Hodà (Rekrutim). Ky mobilizim i ynë nga ana e Turqve bëhesh sepse në Selanik shpërtheu lufta me Grekët dhe Sërbët. Duke përfituar nga kjo situatë, në Vlorë u mblodhën nga një për fshati dhe biseduan midis tyre për të shpallur pavarësin' e atdheut.

Më 20 Tetor Turqia mblodhi ushtëri të rregulltë, të cilën e niste posta-posta për në Janinë. Mbaj mënt se në këtë kohë depua e veshmbathjes u transferua nga Vlora për në Karinë. Më vonë u mblodh paria e rrëthit të Vlorës dhe u bisedua për çështjen e flamurit. Në këtë mbledhje merrja pjesë edhe unë. Mbledhja e parisë caktoj mua që të nisësha për te Myfit Libohova, të cilit i shkruhej që të merte pjesë në ngritjen e flamurit në Vlorë. Unë u nisa me 30 ushtarë për të vendosur rregull me ushtëri që dërgoheshin në Janinë, sepse ata ishin hedhur në aventura — vjedhje. Nevez u nisëm për në Gjirokastrë pikërisht me 8 Nëndor, kur Selaniku dhe Manastiri kishin rarë në duar të grekërve dhe të sërbërve. Kur mësuam neve këtë disfatë të turqve, nuk shkuam më në Janinë. Unë u ndava ushtarve parat e ushqimit dhe shkova në ndihmë të kajmekamit, i cili ndodhej i rrëthuar nga Komitet e Grekut. Te Myfit Libohova, për të zbatuar porosin që më dha Komisjoni i formuar në Vlorë, unë shkova me 30 Ushtarë dhe i propozova që ai të merte pjesë në ngritjen e flamurit, por ai refuzoj, duke pretenduar se ishte e pamundur që të lejonin grekërit të ngrivej flamuri. Në shtëpin e Myfit Libohovës gjeta edhe Sheraf Karagjozin. Unë propozova që të thërritej edhe paria e Gjirokastrës dhe të merte pjesë në ngritjen e flamurit. Sherafi e pa me vënt këtë propozim dhe u zotua që ti lajmëronte dhe të vinte bashkë me 'ta në Vlorë, mir-

*Pjesëmarrës aktiv i çetave të Rilindjes, i luftës së Vlorës më 1920 dhe i luftës nacional-gjirimitare (Shënim i redaksisë).

po — Myfiti nguli këmbë dhe thosh se kjo ishte punë e kotë, sepse grekërit nuk do të lejonin në asnje mënyrë ngritjen e flamurit në Vlorë.

Unë shkova te shokët e mi, jashte Gjirokastres. Në Voshtine mora takim me kajmekamin e atjeshëm dhe ai vendosi qe te ngrinte flamurin; duke mbledhur disa xhandarë që gjëndeshin atje i porositi te ngrinin flamurin dhe ai do te nisej bashke me ne per ne Vlorë. Ne Voshtine flamurin e ngritëm me ceremoni, ku u zbrazen dhe batare pushkësh. Me këngë e valle u kthyem prapë për në Gjirokastrë. Gjirokastritet qenë dakord që te vinin ne Vlorë per te marre pjesë ne ngritjen e flamurit, me gjithë që Myfiti deshi ta sabotonte ngritjen e flamurit. Prej gjirokastre neve u nisëm me të 30 ushtarët per ne Sevaster dhe prej Sevasteri erdhëm ne Vlorë. Mbas 3 ditesh erdhi telegram qe te mblidheshin prapë ushtarë nga mosha 45 deri ne 55 vjeç. Mua më dhane gradën Nëntoger dhe me nisen për në Llogara, ku do të luftonim me grekët. Më 16 Shtator ne Llogara filloj lufta me grekun dhe me daten 28 Nentor, ne mest te natës na erdhi flamuri ne pozicjonet tona. Brënda kësaj dite, po thua, në të gjithë krahiner e Vlorës ishte ngritur flamuri. Më daten 29 nentor neve u bëm thirje Himarjotve dhe i lajmeruam se neve jeshëm shkeputur ng turku dhe keshëm shpallur pavarësin, prandajë ashtu duhesh te vepronin edhe ata. Aty nga fillimi i muajit maj grekerit u terhoqen ne hudutin e tyre.

SOT JU FLAS SI BABAGJYSH

*A dëgjon moj hall' e Vlorës!
Ky shejtan njeriu i ri,
Po tjer flokët e dëborës
Të bëj petka për njeri!*

*Koha qënka e të riut,
Edhe vëndi e kuvëndi,
Sot kërraba e bariut
Është bër dyfek argjëndi!*

E me të vërtetë ky brezi i ri, ashtu si dhe rinia e Vlorës sonë, nuk po lë dy gurë në një qoshe; dhe brënda këtyre 18 vjetve u selit shumë. Rëmo aty e rëmo këtu, rëmoj biblioteka, ka rëmuar e po rëmon në tokë e nëntokë, po ashtu dhe në det e në qiell, dhe bëri sa që guri polli kalli gruri! Edhe peshkun e arratisur në det po e kap dhe e fut në kuti. Çakallin e dëboj dhe ne vënd te britmave të çakallit, po e shurdhojnë dynjallëkun fabrikat me vershellimat e tyre; po njekohesisht me këto këngë të reja te tyre që nusërojnë me stil të vjetër, na shërojnë xhanin me një qejf të ri.

S'di si të vazhdoj, por edhe unë le të rëmoj pak torbën e kujtimeve rrith Vlorës dhe shpejt e shkurt rrith te pavdekëshmit plakut te saj, Ismail Qemalit, me qëllim që të bëj të njohura disa gjëra te vërteta në shërbim të kësaj rinie Vlonjate.—

Shqipëria, tungjatjeta, ka qenë, ësht dhe do të jetë për mot e jetë vëndi i burrave që lejnë me një çift rrufë në dorë dhe me një teste zëmra hekur. Vlora jonë sidomos, ësht dhe der' e bës, e shqiponjës dy krenore; prandaj ne, duke bërë muhabet vlonjatçë, natyrisht na pëlqen të krenohemi edhe më shumë me Vlorën tënë,

sepse kur:

*Ai 1) kish sa bën rëmujë
Ja dërgonin dhe me tela,
Këtij 2) dhe një barmish ujë
Ja bij nëna me buciela!*

*Ai rrëth' e rrrotull hekur,
Ha e pi e vish e ngjish,
Ky dhe kur ish duke vdekur
— Fshinte gjakun me këmishë!*

Duke qënë në këtë gjëndje, Vlora ja bëri forra!

*Jam Vlonjat e jam Vlonjat,
Di bëj luftë me të shtatë.
O me hirë o pahirë
Doemos do rroj i lirë!
Ti ku vete, ku po vete?
Frënk — o Frënk që s'je në vete!*

Ah kjo Vlorë, kjo Vlorë, kjo Vlorë, ngjeshur me brumë baroti, kryevënd i çepeçive që armikut ja hëngri drekët duke ja humbur gjurmën në gjurma të dhive. Ja sepse shqiptaret, e posaçërisht vlonjatet e brohorisën Vlorën, ja sepse edhe unë si një këngëtor i thjeshtë, nën vrullin e kësaj fryme përvëlonjëse Vlonjate, gjysmë shekulli me radhë jam përpjekur të këndoja, kudo që isha, edhe prapa diellit.

*Vlorën edhe Vlorën thelp e kam në zëmër,
Ditën e kam dritë, natën e kam èndërr.
Çdo orë e minutë, ty të kam në gojë.
Mbase të zë lemza kur unë të kujtoj?
Vlora ime e bukur, Vlora ime e lirë
Vetëm ty të dua dhe një gunë të dhirë;
E kudo që isha e kudo që jamte,
Lot në sy të kisha, këng' në buz' të kamte.*

(me këto «jamte» e «kamte» më duket sikur jam brënda në gjirin e saja, i flas në gjuhën e riënës). —

Vlorën dhe vetëm një gunë të dhirë! Sot kjo gunë e dhirë, lumturisht në të pesë kontinentet njihet si një setër e artë.

1) Pushtonjësi italian i 1920-tës

2) Shqiptarit.

Po të mos zgjatemi dhe të mos dalim nga kufiri që na cak-toi ky almanak. Vetëm më lejoni të rëmoj dhe unë një pjesë kuj-timesh, por vetëm nëpër gjurmat e plakut te pavdekshëm: Ismail Qemalit.

Jemi në vitet 1888-1889. Në këtë kohë Sulltani i Turqisë quhej «hija e Perëndisë në faqen e dheut». Për atë nuk paskish vdekje; ai vdiste kur i tekej, duke lëpirë një myhyr të veçantë të tij. Ish i fuqishëm. Kufia tokësore shtrihej nga Persia në Shkodër e në Bosnjë, kufia fetare: deri në Java. E kush mund të bënte gëk? Një nga gjemit' e tija e quajtura «Mahmudije» paskësh qenë aqë e madhe sa që dy vlllezër, duke u ndodhur brënda si marinarë, gjatë një viti nuk mundën të takoheshin njëri me tjetrin. Kjo gjemi ngrivej vvetetiu pa timonier dhe shkonte e bombardonte buzdetet armike!!

Të tilla përralla aty këtu gjënin vënd e përhapeshin.

Në këtë kohë ish që mua më ra ne vesh emri i Ismail Qemalit, si një «njeri i ditur por shejtan, dhe herë herë si rrebel» kundër botkuptimit të ditës.

Në këtë kohë në Vlorë hynin aty-këtu fshehurazi — vjersha dhe libra te shkruara jo si «urdheronte Zoti» me gërmë te tija, nga e djathta në të mëngjër, por «përsepraphthi», nga e mëngjëra në të djathët!

Midis popullit, u shfaqën disa njerës që i përdornin këto gërmë dhe kishin hyrë në korrispondencë te fshehte me disa shqiptare të tjerë si p.sh. me një Dudë Karbunara në Berat, me një Sheh Sabri në Prevezë e të tjerë. Edhe unë, megjithse djal' i një theologu të njojur, nuk mjaftova me mejtabin (shkollën) që na mësonte turqisht, arabisht e persishtë, por bashke me shokë si Koleka, Karbunara e tjerë nisa të veja edhe në skoli për të mësuar allfavitën greqisht.

Në këtë gjendje isha me 1889 kur shkova në Janinë për të — ndjekur mësimet në gjimnazin e atij qyteti. Aty kush më parë e kush më vonë u mblohdhën 7-8 vetë nga Vlora e Kanina, të gjithe ne konvikt. Por aty ramë në kontakt me elementa të vënëdit. Të ndihmuar edhe nga mësimet, na u ngjall një dëshirë aguridhe për një farë lirije patriotike simbas kohës.

Një ditë arrin në Janinë babai i shokut tonë, Mahmud Myftiu nga Kanina, me të cilin unë dhe i biri i tij u kthyem në Vlorë. Gjatë udhëtimit, ne recitonim vjersha tyrqisht. Mahmudi na pyeti: «A dini të shkruani shqip siç shkruan Duçe Jorgo Baba, djalë si ju? Ai shkruan dhe këndon patriotët shqiptarë si Ismail Qemalin, Naim Frashërin e tjerë. Ky vlonjati ynë, Ismail Qemali, është njeri i math. Është nga tarafi i Kastriotëve e jo i sulltanit.» Dhe na porositi të mos flisnim përjashta se na bëjnë syrgjyn.

Më vonë i mësuam vjershat e Duçe Jorgo Babës, pseudonim i një djali nga familja Strati qe i perbuzur nga rrëthi i tij e shoqeria mbaroi i çmendur ne nje Manastir te Ajinorosit. Ja vjersha e tij për Ismail Qemalin (rreth vitit 1900).

*Fryte drit e Shqipérise
Jashtë nga qytet i errët,
Ti vësh dérmën dhëlpérise
E të gëzoç ne të mjerët.*

*Ti që kur dole në jetë,
Që kur bëri nëna djalë
Kokën e mbajte përpjetë,
Edhe shpirtin zjarr e valë...*

Kur Ismail Qemali u kthye ne Vlorë me 1908, si gjithë të mërguarit politikë, këtë vjershë e recitoj Dr. Epaminondë Koleka, para plakut porsa ky shkeli në mol. —

Më 1902 kisha shkuar per te ndjekur mësimet Universitare në Stamboll. Ato kohra dhe gjatë viteve më vonë, ne vilajetin e Janinës, ngjajtën shumë ngatrresa e internime. Si shumë patriotë nga viset e tjera, edhe nga Vlora u internuan disa njerëzë dhe veçanërisht dy vetë u bënë syrgjyn për nën Halep-Urfa (Siri). Njëri nga te dy ishte Mahmud Myftiu. Ne kete kohë Kryeministër i Tyrqisë ishte Ferid Pashë Vlora.

Më 1909 u ndodha si stazhant në Janinë kur ngjau grushti i — Shtetit në Stamboll që njihet me emrin «31 Mars». Komanda e divizjonit te Janinës thirri gjithë shqiptaret në klubin «Bashkimi» dhe na foli për këtë grusht shteti, duke qëlluar rëndë si flamurtar të tij Ismail Qemalin dhe na ftoi ta hidhним poshtë këtë njeri.

Ismail Qemali, atë kohë, për veprimtarin e tij patriotike shqiptare ishte ne armiqesi të rreptë me Xhon Turqit: hiqe ta heqëm.

Unë se bashku me Major Zia Mesareja, ishim antare te kshillit te klubit. Ne të dy, muarrëm fjalën dhe u përgjegjëm me nje gjuhë të ashpër, duke hedhur poshtë akuzat e komandës. Si konsekuençë e ketij qëndrimi, Ministri i Mbrëndshëm i Qeverisë turke urdheroj internimin tim ne Halep (Syri) dhe te Zia Mesaresë në Selanik. Si Ministër i brëndëshme ne kete kohë ishte Ferid Pashë Vlora.

Duke kaluar ngjarjet e mëdha që dihen nga të gjithë, do ju tregoj disa raste kur plaku i Shqipérise me 1913 u vu ne mërzitje e vështiresi te rënda nga disa intrigantë të brëndësh-

më, herë herë dhe nga njerës me besim të mirë, po naivë e të gabuar edhe nga fuqit e mëdha, të cilat bëheshin edhe mik edhe armik, sipas interesit qe kishin dhe sipas furtunave që po afroheshin.

Si funksionar të afërt që më kish emruar, unë ndodhesha përdita pranë tij dhe sidomos kohët e fundit, prej orës 8 të mëngjesit e deri në mes të natës.

Një ditë më thotë: «Bëni diçka». Ishte koha kur qeverimi i Shqiperise po perçuhej. Unë së pari u çuditua kur plaku m'u drejtua mua vetëm dhe jo shokëve të tij, pjestarë të qeverisë. Në çast pastaj kuptova gjëndjen e tij shpirtnore dhe formova idenë se për ç'arësy plaku nuk mund t'u thoshte të tjerëve atë që mbante në zëmër. Dëshira e tij ishte që unë në bashkëpunim të imtë me ata që njihja mirë, të organizonim në mënyrë spontane nië meting të math në të cilin populli të shprehë besimin dhe dashurinë që kish në të dhe në qeverin e tij. Por ne nuk bëmë sa duhej bërë; ishim te pa organizuar; na lidhët vetëm respekti per flamurin dhe flamurtarin. Kështu që unë mjaftova duke shkruar me dorën time një telegram që hoqëm nga qyteti ne Skelë ku shfaqesh besimi dhe mirënjojja e vëndit ndaj tij. Këtë telegram e firmuam bashkë me një grup nga populli që quheshin si krerët. Kur e mori në darkë këtë telegram, Ismail Qemali më tha: «Bosh!» Sepse nuk u bë ajo që duhei. Po kështhu pas disa muajve, pikërisht me 22 Janar 1914, passi kaloi një natë pa gjumë, duke pirë me një kokër sheqer më shumë se 15 gata çaj, ashtu siç e kish zakon, ne mëngjes më thirri e më tha: «Ali! Eja se do vemi në Beledije (Bashki).»

Së bashku hipur në karrocën presidenciale, nga Skela vamë në Bashki brënda ne qytet. Aty ishin mbledhur shumica e antarve te kabinetit.

Plaku u ul në tryezë që ndodhej në mes të dhomës duke më ftuar dhe mua pranë tij. «Shkruaj!» më tha, por në çast shtoi: «Nëma ta shkruaj vetë» dhe shkroi me dorën e tija telegramin me të cilin lajmeronte dorëheqjen dhe i linte lamtumirën atdheut dhe popullit shqiptar. Daten e kam vënë unë me dorën time, ashtu dhe një korrigjim që duket në telegram e kam bërë unë me pëlqimin e tij¹⁾

Siç shihet, Vlora bëri çmos që të mos përçuhej Shqipërija dhe të qëndronte me të vetmen qeveri dhe me flamurtarin e sajë në krye, por fatkeqësisht nuk ndodhi kështu; intrigat e am-

1) Telegrami është botuar 25 vjet më parë me gjithë hollësirat e shënuara më sipër dhe origjinali i është dorëzuar, pas qirimit ish Institut tonë të Shkencave së bashku me dokumenta të tjera rreth — Ismail Qemalit dhe Qeveris së tij. (Shënim i auktorit).

bicjozëve dhe armiqt vazhduan të godasin rëndë plakun. «Duhet të ikij ky, që të bashkohet e të shpëtojë Shqipërija» — thoshin ata.

Por me largimin e tij, Shqiperia jo vetëm që nuk u bashkua, po u godit në palcë dhe u bë lesh e lì, me një tufë qeverish, sa që për pak e mori lumi e deti. —

Të dashur lexonjës!

Rruferat kanë sevda të sulmojnë dhe të qëllojnë malet e larta dhe kur gjëjnë vënd të përshtatshëm, bëjnë shkrumb e hi. Ne nuk ishim te organizuar dhe për të thënë të drejtën, në dy shtepi ishim 3 pleq dhe tri parti ne një lagje.

Sedra individuale ishte e madhe; tarafet, ambicjet, ua shtoinin oreksin armiqve; bile disa që më parë ishin miq të plakut, muarën qëndrim kundër tij dhe në dëm të atdheut.

Sot Shqipëria është organizuar, është bër një shkëmb monolit.

Për rruferat që kurdoherë kanë sevda te sulmojne malet e larta dhe për armikun që godit aty ku të prish e ku të dhëmb, s'ka më vënd e kuvënd.

Ta festojmë pra, me gjallëri e entuziazëm 50 vjetorin e pamvarësisë kombëtare së bashku me 18 vjetorin e çlirimit, ash tu siç i ka hije fisit shqiptar, 4000 vjet këmborë.

50 vjetori, si gjithë Shqipërin edhe Vlorën tonë të dashur, po e gjën shumë të bukur e të lulëzuar dhe si kurdoherë, derë babe të shqipes dy krenore, në saje të udhëheqjes së sotme, tashmë të provuar si bërthamë vrulli patriotik dhe bërthamë truri të mbarë popullit arbëror. —

MEXHIDJA E SELAMIT¹⁾

Ç'u nise nga Drashovica
Bëre parë nga Babica
Posi dielli me çika
Ç'e zure topin nga gryka
Selam Musai o lule!...
(E popullit).

Aty nga viti 1921, pas mbarimit të luftës së Vlorës, në një dyqan të errët të një bakalli të vogël, at e bir bisedojnë:

— Pa shiko, o bir, atë defterin e veresievet, dhe nxiri emrat e atyre fshatarve që na kanë mbetur borxh para se të fillonte lufta.

Dhe i biri, duke shkarravitur nëpër gjishtat e vet lapsin e vogël, nxirte emra pas emrash, kur befas qëndroi dhe i mbërrtheu syt mbi një emër të njohur; e pyet tanë:

— Selam Musa Salaria, na paska borxh një mexhide? Mos ësht ay i këngës?

— Po biro, ay është. Ay s'na ka asnje borxh, as neve, as Vlorës, as Shqipërisë.

— Ta fshij emrin?

— Jo! ruaje si kujtim se ay emër vlen më tenë se sa tërë defterët tanë; Selami i lau borxhet me gjakun e tij. I gjori Lap, s'kish pasur as sheqer, as oris, as beze, as krypë; erdhi i mori veresie tek ne dhe s'pati kohë t'i lante borxhet. Me gjithë fukarallëkun, ay mori pushkën kurr Vlora e thirri dhe e zuri topin nga gryka.

— Po varrin ku e ka?

— Varrin? Po ay s'ka varr. S'mbeti thrime nga trupi i tij dhe i treqind shokëve te tij. Gjithë topat e Italianit çkrinë mbi trupat e fatosave, po zëmrën e labit s'e çkrinë dot.

Tërë flloata e Sazanit, e pashalimanit, e karaburunit i lëshoj bateritë e saj mbi festebardhët që patën hedhur gunat mbi te-

1) Ngjarje e vërtetë.

lat me gjëmba dhe me afshin e zëmrën çanë rrugën drejt spitalit. Të tërë festebardhët pa opinga u vranë; s'u mbeti as nishan; po u mbeti nami. Dëgjo biro te sheshi i flamurit sesi kërcet kënga e tyre:

— *Qaf' e Koçiuut moj grykë
Ç'hata bëre atë ditë
Me top e me alitrikë,
Vrave djemt e shqiperise;
Katërqind e ca shehitë,
Katerqind e ca të vrarë.*
.....

Dhe përmes asaj kënge, në sheshin legjendar ku ësht ngri-tur flamuri, dukesh sikur bashkë me popullin këndonin lapçë edhe trimat me fletë që, ndonse fëmijët i kishin pa bukë, muarrën armët dhe shkuan të luftojnë për mëmëdhe. Se njerzit e thjeshtë e ndiejnë më tepër se kushdo dashurinë për atdhe. Dhe s'ka top në botë që ta thërrmojë zëmrën e tyre të madhe.

Njerëz si Selam Musaj nuk vdesin kurrë. Ndaj dhe atdheu i Shqiponjavet është i pavdekshëm. —

SHEVQET MUSARAJ

I VDEKURI I PA VDEKSHËM (kujtime vegjëlie)

Atë ditë mësonjësi i vizatimit në shkollën e Muradijes, që e kish zakon te hynte në klasë pesë minuta para se te binte zilja, nuk erdhi në orar.

Ne hymë pa zhurmë, të sigurt që do e gjënim brënda, ash tu si gjithënje, duke vizatuar me shkumës në drrasën e zezë ndonjë fletë rrapi, një trëndafil, ose një cjak me brirë të gjatë. Dhe vonë na ra në sy që ai s'kishte ardhur. Atëhere ja filluan zhurmës, të gëzuar që mësonjësi s'do të vinte, pa na shkuar fare ndër mënd se mund të ish i sëmurë, ose mund t'i kish ndodhur ndonjë fatkeqësi tjetër.

Disa ja nisnë këngës, të tjerë vërvellenin ose thërrisin shoku-shokun dhe sejcili po fuste librat në trastë për të ikur. Ku kish më mirë? Lart nga Aplema na priste laga-terra.

Kur, tamëm kur të parët kishin arritur te dera, u dëgjuan thirrje pakënaqësie: «Mësonjësi!... Po vjen mësonjësi!» dhe e të rrë ajo zhurmë që zjente si koshere bletësh në klasë u pre përnjéherësh sikur gjithë fëmijët të kishin një gojë të përbashkët dhe atë gojë e mylli një dorë e padukëshme.

Mësonjësi hyri pa folë, me fytyrën dyllë të verdhë, me sy të unjur dhe me buzën që i dridhej. Nuk kish me vehte as çantë, as fletore vizatimi.

U kthyem pa bërë gëk sejcili në vëndin e tij. Ai bëri dhe disa hapa përparrë me një të ecur që të shtinte frikën, duke u lëkundur sa djathtas majtas gadi sa s'po rrëzohej dhe, si i u afrua tryezës, u mbështet fort për të, mori frymë thellë, lidhi duart e na u drejtua neve:

— Sot s'do bëjmë mësim...

I tha këto fjalë me zë të mallëngjyer, një e nga një, sikur mezi i dilnin nga gjoksi, sikur ajo frymë që mori nuk i mjaftoi

dhe në një mënyrë që të linte të kuptoje se diçka i kish ndodhur, ndonjë hatà e madhe, s'gurisht.

Në klasë u dëgjuan pëshpëritje të mekura: «Do jetë sëmu-rë»... «Mos i ka vdekur njeri»... «Ndofta e kanë pushuar»...

Mësonjësi ngriti kryet me atë ball të lartë që i nxinte sterrë, lëvizi si me mundim vetullat e tij te trasha dhe, duke përmbledhur fuqitë, tha me një zë të pikëlluar:

— Ju jini akoma të vegjël... Vonë do ta kuptioni se ç'hatà e madhe e gjeti Shqiperinë.... Kanë vrarë Avni Rustemin!

Dhe s'vazhdoi dot më. E mbytnë lotët. —

Kanë vrarë Avni Rustemin! (Sa ngjethëse më tingëllojnë këto fjalë edhe sot, pas 38 vjetve!) Nxënësit mbetnë si të mpirë me sytë te mësonjësi dhe dukej sikur as frymë nuk merrnin. Jo se dinin cili ishte ai njeri i math që kish humbur atë ditë Shqipërija, po u preknë nga lotët e mësonjësit. «Mësonjësi po qan!» Kur kish ndodhur ndonjëherë kjo, që mësonjësi të qante në sy të nxënësve? Aq më tepër ai, mësonjësi ynë i vizatimit, që na bënte të shkuleshim së qeshuri me ato vrejtjet e tij tërë thumba kur na kontrollonte vizatimet: «M'a paske vizatuar atë fletë sikur e ka ngrënë gomari... Po këtij cjapit tënd, ujku ja ka ngrënë njerën këmbë?... Po pse kështu, more bir? Pa bisht i kini macet ju atje në fshatin tuaj?» e të tjera.

Në fillim edhe unë u hutova po aqë sa të tjerët, dhe, njësoj si ata, ja kisha ngulur sytë mësonjësit me keqardhje. Po, pas cazë, nuk di se si m'u bë sikur ai emri i njeriut që përmëndi mësonjësi më tingëlloi në kokë më fort e më qartë: *Avni Rustemi!*

Pa dashur lëviza nga vëndi duke tërhequr kështu kureshtjen e të tjerëve që edhe frymë merrnin si me të drojtur.

«Kanë vrarë Avni Rustemin? Ç'thotë kështu Zoti mësonjës? Kush e vrau? Pse? Ai ish aq i mirë, aq' i dashur...» Dhe, si nëpër një mjegull të hollë, që po më vishte sytë, kisha tanë përrpara meje, në vënd të mësonjësit, fytyrën e hequr me vetulla të zeza të Avniut kur hynte e dilte shpesh në shtëpinë ku banonte me qira Halim Xhelua me familje — shtëpija e Mustafa Kucit në lagjen e re, afër spitalit, në atë rrugicën prej kalldrëmi të vjetër që ngjitej përpjetë bregut me ullinj.

«Paskan vrarë Avninë? Sa gjynah! po pse? Pse? Ai ish aq i mirë, aq i dashur....»

Në shtëpinë e Halimit kish rënë zija. Oda sipër, me dritat e tē mëdha, që s'kish mbrëmje te mos ziente nga bisedat e zjarrta tē Halimit me shokë, ish e heshtur dhe e errët. Kurse poshtë, në dritën e zbehtë tē një llambe vajguri, dy plaka fshatare, — gjyshja dhe nëna e Halimit — mallkonin or' e pa kohë «dorën që bëri hatanë». E shoqja qante me lotë që i kullonin mbi djep te po i jepje gjë fëmijës që ta pushonte.

Unë mbeta më këmbë te dera dhe s'guxonja tē vë në vend as trastën me libra.

Atë mbrëmje në shtëpi tē Halimit nuk u shtrua sofër dhe vetë Halimi e kaloi tërë natën përjashta. Thoshnin se kishte punë me popullin dhe me gazetën.

Kur u gdhi, rrugët e Vlorës buiznin nga njerëzit. Nëpër mure, në shtyllat e telefçnit dhe neper vetrinat e dyqaneve ishin ngjitur copa letre me vijë tē zezë anës, tē shkruara me gërmë tē mëdha: «*Zi për heroin kombëtar Avni Rustemin!*» Dorë më dorë qarkullonte një broshurë e vockël me kapak tē hollë ngjyrë trëndafili. Ish një vjershë e gjatë që bënte fjalë për Avniun, e shkruar në dialektin e Kosovës që ne tē vegjlit mezi e kuptionim dhe, megjithatë mundoreshim ta mësonim përmendsh. Vajza dhe djem tē rritur hynin nëpër oborre shtepish qe kishin lule dhe dilnin me tufa ne duar. Vlora prengatit te priste ne gjirin e saj trupin e Avniut që po e sillnin me det nga Durrësi.

Një lumë i madh njerëzish e kurorash mbulonte më vonë tejpërtej rrugën Vlorë-Skelë! Mua më mbetnë sytë te një grup vajzash në krye tē korteut. Ishin si nja njëzet a tridhjetë, të veshura me fustane te bardha, me kryet mbështjellë me lajurë tē zinj që u vareshin prapa gjer në mes tē shpatullave. Prapa tyre ecte ngadalë, me hapin e rënduar tē njerëzve, qerrja mortuare e tërhequr nga kuaj tē lartë tē mbuluar fund e krye me irobë tē zezë, aqë sa u dukeshin vetëm sytë nëpër vrimat e lëna apostafat. Pastaj — burra dhe grà që hiqnin në zëmër e qanin. Pashë në mes tē tyre mësonjësin e vizatimit. Ai s'qante fare tashti, po, për kundrazi, kthente herë pas here kokën nga Halimi që ecte më tē djathtë tē tij dhe i pëshpëriste nga një fjalë. Edhe Halimi dukej që s'kish derdhur lotë, vetëm se rrinte si i menduar dhe, kur i përgjigjej mësonjësit, mvrëhej e revoltuej. Mua më vinte inat që ata tē dy e kishin kaluar kaqë shpejt helmin e Avniut.

Kollona me kurora dhe njerëz nuk kish tē mbaruar. Trego-

min se, kur kryet kish arritur në të hyrë të qytetit, fundi ish akoma në molo të Skelës.-

Në Sheshin e Flamurit, ku s'kish ku të hidhje mollën as në ballkonet e çatitë e shtëpive rrëth e rrëth, u mbajtën fjali-me. Një — Doktor — Sezai Çomo e quanin dhe flitej se kish të bënte me Avninë — sa nisi fjalën, ja plasi të qarit dhe nuk vazhdoi më, po mbuloi fytyrën me pëllëmbë të duarve dhe u tërroq nga tribuna.

Nuk di ç'ndodhi më tej. Po, pas ca kohe, unë u gjënda në mes të një vargu të pa mbaruar njerëzish, që hynin dy e nga dy në Bashkinë e qytetit dhe ngjiteshin lart shkallëve për në sallën e madhe, me tavan e mure të piktuuar, ku ish ekspozuar, në mes të luleve dhe të flamurëve, arkivoli i Avni Rustemit. Dhe putha, si të gjithë të tjerët, kur më erdhi radha, xhamin e kristaltë ndënë të cilin dukej, si në një gjumë të ëmbël, fytyra e hequr e të vdekurit të pavdekshëm. —

Tiranë, 1962

KOLONEL: BANUSH GOXHAJ

KËTEJ S'KALONI

NGA AKSJONET E PARA KUNDËR USHTRISË FASHISTË NË RRETHIN E VLORËS.

Pas goditjes së milicis fashiste, djegies së depos municjonit në Aplemë (Qyteti i Vlorës) si dhe prerjes së të gjitha linjave telegrafonike më 24 Korrik 1942, komanda ushtarake fashiste e alarmuar dhe duke e ndjerë se po i shkiste toka nën këmbë, shumëfishoi masat e sigurimit të objekteve ushtarake dhe, përtë lehtësuar sherbimet informative midis krahinave Mesaplik-Kurvelesh dhe qëndrës në Vlorë, vendosi të bëjë një linjë të re. Për këtë qëllim dërgoj një kompani ushtarë të armatosur deri në dhëmbë e të stervitur si alpiniste. Komiteti Qarkor i P.K. në Vlorë, sa po mori vesh këtë lajm, vendosi që kjo kompani me çdo kusht të shkatërrrohesh, ashtu si gjithënjë, me qëllim që të démitohej armiku, t'i merreshin armët dhe ai të mos zgjaste dot duart e përgjakura në këto male kreshnike që s'e njojin kurri robërinë.

Prita u zgjodh të bëhesh në katundin Tërbac (Qafa e Pllumbit), u vendos këtu jo vetëm si vënd strategjik, por edhe sepse elementi me tendenca reaksjonare shpesh herë flisin që Hysni Kapo dhe shokët e tij le ta ndezin zjarriir në shtëpitë e tyre; sido qoftë, kjo u vendos dhe, kur komunistët vendosën, ata s'dinë të kthehen prapë. Kështu, më 27 Shtator të vitit 1942 komunisti «Bogonica» bashkë me 3 shokët e tij u mblodhën në shtëpinë e Feim Nikës, Lagja Lekaj-Tërbac. Bisuedan me zjarr dhe urrejtje për armikun. «Bogonica» duke marrë fjalën, tha: «Shokë: Komiteti Qarkor ka vendosur të goditet kompania e ushtarëve fashistë e cila është ngarkuar për rregullimin e linjave në krahinën Mesaplik-Kurvelesh. Vendimi i Partisë gjënpaprohimi në zëmrat e të gjithëve dhe do të zbatohet. Kundërshtarët vijnë me makina dhe në mbrëmje kthehen përsëri; janë t'armatosur me të gjitha mjetet; ne kemi vetëm 4 pushkë dhe një mitrolaz «Lebel», por jemi 4 komunistë mendoj se duhet të gjejmë dhe 10 ushtarë populli; llogaritja bëhet një me pe-

së, por ne do ja dalim, do fitojmë; sikur edhe 1 me 50 të jemi përsëri do të fitojmë, se toka mbi të cilën luftojmë është e jona dhe na jep fuqi.» Propozimi i Shokut «Bogonica» gjeti aprosim të njëzëshëm, partizanëve nuk u pritej sa të vinte çasti i veprimit. U njoftua njësiti i fshatit Tërbaç, midis tyre edhe Karafili që s'i kish mbushë të 15 vjetët, po në ballin dhe ftyrën e tij lëxohej guximi, trimëria shëmbëllore, dashuria e pakufishme për Partinë e Atdheun dhe urrejtja për okupatorin. Atij nuk ja hante qëni shkopin për trimëri dhe guxim.

Më 28 Shtator 1942, në mbrëmje, shokët e njësitet një nga një u grumbulluan në vëndin e caktuar; nga 8 që u njoftuan erdhën 9, shumica nuk kishin pushkë, por syri i tyre shkëlqente dhe besimi ish i patundur se do t'ja mernin armikut e do dilnin faqebardhë. Në këtë mbledhje u ndanë edhe detyrat, kështu p.sh. Shoku «Bogonica» dhe I.GJ. do ishin ballë për ballë me armikun dhe do të përdornin mitrozin që shpesh herë ngekte si i vjetër; Shoku X do t'i ftonte italisht kundërshtarët që të dorëzoheshin se vetëm kështu do të shpëtonin lëkurën e tyre; shokët e tjerë u vendosën në pozicjone që të shtinin mbi armikun; Karafili, si më i ri që ish, u caktua me detyrë që të qëndronte nga 15 metra larg pritës me qëllim që të vrejtonte dhe të mbante ndërlichjen. Me gjithëse ai nuk ish i kënaqur, tundi kokën në shënje pohimi. Mbas ndarjes së detyrave, zunë vënd të gjithë dhe prisnin pa durim ardhjen e kollonës armike për të filluar përlleshjen.

Ajo natë shtatori, megjithë se e kthjellët dhe hëna ndriste lisat shekullorë, u duk e gjatë, kështu ndodh kur do të marrësh hakë. Shpesh dëgjohej zëri i disave «kur do të gdihet, u zgjat shumë nata» etj. Dikush tregonte se si Zaho Koka dhe të tjerë komunistë vranë në pritë fashistin Tenente Moretin në Vuno; një tjetër thosh se si më 24 Korrik u prenë linjat telefonike në të gjithë shqipërinë në një natë dhe në një orë; njeri bile, me zë të lartë, tha: «Ju s'i kini parë si ulëritën milicët kur u sulmuani nga njësiti guerril i qytetit të Vlorës n'Aplemë, ai bile tregoi se si «Besniku» në Lagjen vrenez u përpinq me patrullën e kuesturës dhe, me gjithëse ishte 1 me 4, me një të shtënë revolveri dhe një granatë u futi tmerin fashistave dhe u kthyte shëndoshë e mirë; me sa duket, plumbi i ha frikacakët kurse trimave u liron rrugën. Me këto biseda kaloj nata dhe ja zëri i Bogonicës: «Shokë, tha ai, ora vate 6; rrëth orës 8 ushtarët fashistë do të kalojnë këtu, prandaj duhet të vendosemi nëpër vënde». Të gjithë shkuan me vrap në pozicionet e tyre. Vetëm Karafili po ecte i menduar dhe dukesh si i pakënaqur. Papritur qëndroi në vënd dhe ju drejtua shokut X: «Po pse mua më caktuat aqë larg, mos

më keni marrë për frikacak? Jo, unë nuk kam frikë, duhet të jem në ballë përballë me armikun, më provoni.» Dhe menjëherë zuri vënd shumë afër rrugës dhe, passi grumbullooi disa gurë të shtuftë, u shtri në pozicjon.

Tani që shokët ishin vendosur nëpër vëndet e caktuara, minutat filluan prapë të zgjateshin dhe aty-këtu filluan pëshpëritje: «Po sikur të mos vijnë?» Por Hasani, i cili ish verdosur në kodrën më dominonjëse, thirri: «Shokë, dy makina me ushtarë italianë po vijnë te Police Brate (fusha)»; të gjithë u gëzuan nga ky lajm dhe po prisnin çastin e goditjes.-

Maqina e parë u fut në pritë. Sipas planit u bë thirrja që të dorëzoheshin por fashistët rezistuan, armiku nuk dorëzohet kollaj. Në të njëjtën kohë, Shoku «Bogonica» dhe I. Gj.. hapën zjarr me mitroloz. Karafili, që mezi e kish pritur këtë çast, u ra para se t'i jepesh urdhëri dhe thirri: «Ku vini breshkamëdhënëj, këtu nuk kalohet, se ha pula stërrall». Fashistët italianë bërtitën: «Mama mia, non sparate, siamo fratelli» e tjera. Aksioni u krye me sukses dhe shokët u larguan pa asnje humbje.

Për këtë aksjon ja se ç' shkruan komunikata e milicisë fashiste datë 30 Shtator 1942:

«Tiranë 30 Shtator, 1942. Të rejet e mëngjezit datë 29 Shtatorit 1942: P. T. Kryesisë Këshillit Ministruer Tiranë:

Vlorë Nr 1. N'orën 9,25 të vazhdusit në qafën e Pullumbit Brataj, një çetë e armatosur prej 20 personash, mbassi patën pengue me gurë rrugën, mësyen me një mitraliatrice, me pushkë e me bomba dore, dy autokorjera me 36 ushtarë dhe 2 oficera, drejtue Vranisht për të rregullue linjen telefonike. U plagosën 13 ushtarë, ndër të cilët 2 rëndë; ushtarakët i përgjigjeshin zjarrit pa përfundim Vazhdojnë hetimet. N/Drejtor i Përgjithshëm i Policisë: Sh. Borshi dv.»

Në mbrëmjen e datës 29 shtator, për terror e raprezalje, u dërguan në Tërbaç mbi 700 milicë e karabinierë, të udhëhequr nga traditari Reuf Shehu, Toger i Milicisë Fashiste, dhe në shenjë hakmarrje, dogjëri shtëpitë e komunistave si dhe të 3 fshatarëve të tjerë; por djegjet dhe raprezaljet nuk i tronditën për asnje çast trimat që i kishin dalë për zot lirisë.

Ashtu si për gjithë popullin shqiptar edhe për popullin e kësaj krahine aksjoni i Qafës Pullumbit, u bë forcë e gjallë dhe mobilizonjëse.

Mbas këtij aksjoni, populli e shtoi më shumë urrejtjen kundër armikut dhe filloj pjesëmarrjen aktive në luftë kundër okupatorit dhe tradhtarvet, deri sa aguan ditët e bardha të lirisë dhe pamvarësisë.-

SELIM HASANI:
(rapsod popullor)

SMAIL BEU I VARFËRI

Smail Beu i varfëri
S'desh çifligje e pasuri,
Gjezdis me libra në gji,
Lufton kundraj me Turqi:
«Ku jam se dua të di
Shqipëtar a Turçelli.
E dua se kam të drejtë,
Nga Parizi pse me çkretë?»¹⁾
Gjezdisi det e steretë
Me ca libra të mëshehtë,
Nga Skënderbeu i kish gjetë
Nënteqindedyimbëdhjetë
Flamurin në Vlorë e ngretë.
Foli Smail beu vetë:
«Ka qenë i bllokuar gjektë
Ky është flamuri ynë
Bënë ca sikur s'e njihnë,
Esat Pasha me Mvfitnë
Kosovën në bot e shitnë».

KANINA NËNË KALA

Kaninë nënë kalà
Ç'u ndodh vëndi me xhefà²⁾
Ç'i qëllon halla-hallà
Topi vreshtave mëdhà
Kush u hoth tutje në ta
Deli Beqiri me ca

1) më çkrehtë — më ndoqtë, më përzutë.

2) xhefa — vuajtje, mundim.

Edhe Alem Canua
Brataj Memo Meteja
Dolli vetë Bozua
Vuri dylbitë dhe pà
E shkreta kjo kazà
Të bukur trima që kà

KUSH E ZGJOI SHQIPËRINË

Kush e zgjoi Shqipërinë,
Avdul Beu me Naimnë,
Ismail Qemali ynë
Prishnë yçynxhi ordhinë
rrëzuan Sulttan Haminë.
Qemali la porosinë:
«Në fitofshi Republikë,
Vini topat në Kaninë,
Të siguroni kufinë,
Sazan e Adriatiknë.»
Qemal mos na ki lloinë,
Se kemi gjetur profinë
Enver Hoxhë gjuh bilbilë
Çau jugën e verinë,
Hariti gjera në Kinë.

QAJ MOJ VLORË RRËNJËDALË

Qaj moj Vlorë rrënjëdalë
Qaj për Ismail Qemalë
Ngriti flamurin me zhgabë
Si e ngriti ashtu e lanë
Ca godoshë endresanë ³⁾
Me çifligje, me dyqanë
Popullin bujq e çobanë
Prandaj e shitën vatanë
Prunë Duçe Italianë
Na zuri Pasha limanë
Me topa mbushi Sazanë,
Po ia muarr djemtë tanë
Enveri me partizanë

3) endresanë — interesaxhinxj

Mehmeti që qe në Spanjë
nga zotësia që panë,
Me Sovjetik u përkranë,
Me Kinez' e Koreanë,
Vërtet ashtu si na thanë
Do ta luftojmë gjermanë
Po për buk e po për armë?
Marrëm në ata që kanë
Dyfeqet në italiannë,
Korçekët në agallarë
Hopinga nëpër fshatarë,
Hajde djem u bëft e mbarë.

NGA SAZANI VJEN PAMPORRI

Nga Sazani vjen pamporri
Në Vlor Italia dolli
Na thosh Duçe bagaboni 4)
Do ta bëj fushë fotbolli.
Barbarë mos na shtrëngoni,
Të njëzetën e mejtoni
Mos thoni se do fitoni
Me dhën e me dhi do shkonii,
Me bucjela do ngarkoni.
Ç'thosh Prefekti e Prokurori?
Ç'kemi Sadik Duro Qorri?
Me partizanë na polli,
Far' e Qemalit që mbolli,
Enveri me shok e korri
Popullin në dritë e nxori,
Nxori popullin në dritë
Në pun i futi të gjithë
Inxhinjer e mekanikë

SHQIPERI LULE BURBUQE

Shqipëri lule burbuqe
Ke qënë në mes të ujqe
Pesëqind e ca vjet mbushe
Tinë shqip e ata turce

4) bakaboni — shtrëmbrim i fjalës «Vagabondi»,

Qysh erth koha u çkëputë
Kërkon Qemali hudute
Libr' e propagandë fute,
nëpër shkolla e nëpër burgje
Vure flamurin në dukje,
Moj Parti luftën e tunde
Ndoqe deshëtë me buqë
Bejlerëtë me kulltuqe
Me kapella lugje-lugje,
Ç'i flake të gjithë tutje.

SHQIPERI MOJ HALLE MADHE

Shqipëri moj halle madhe
E vogëlë në ballkane
Ndoqe ushterin' gjermane
Tunde fusha, tunde male
Të gjitha me gjak i lave,
Moj e shkretë qysh i çave,
Bejlerët me kapitale
Që rrijnë me kuaj shale.
Ah! ç'ua bëre mirë cave
Si pishkun për uj i thave
Ç'i shitnë mantot e grave
Qaf' e supe me kundadhe.

SHQIPERI E HALLEVE

Shqipëri e hallevë
Me mijëra vjetë ke
Të bë lufta kallame,
Seneja dyzetetë
Situata qysh u kthe
Një drit e një jet e re,
Partia më këmb u ngre
Enver Hoxh' e Mehmet Sheh
Krerëve ballit u the:
«Ja me ne, ja kundra ne,
Ja këtej ja s'ka çare».
Ç'i këputë dy e tre

Ç'i çkrehe me teneqe.
Dhe ca persona që le
Tabellën prapa ua ke
Bënu popull një ide,
Të punojmë pér Atdhe
Ta bëjmë lule bahçe,
Kanalet në Myzeqe
Malet të gjithë xhade.

SHKOLLA SHQIPE NË SHEKULLIN XVI, XVII.

Pas vdekjes së Skënderbeut, krahina e Himarës vazhdoi luftrat kundër sulltanëve. Asokohe Himara shtrihej nga Radhima gjer në Butrinto. Luftra të përgjakëshme janë bërë në këtë krahinë heroike, ku sulltanët kanë thyer kokën njëri pas tjetrit.

«....Dije o at i shënjtë, se qysh nga koha e të paepurit Skënderbe, të madhit mbretit tonë, të mbiquajtur Kastriot, asnë herë kurrë dhe askush, as edhe më i egëri dhe i pamëshirëshmi turk, me gjithë forcat e tij të pashteruara, nuk ka mundur kurrë të na mposhtë dhe të na gjunjëzojë e të na nënështrojë nën zgjedhën e perandorisë së tij, megjithëse ditë për ditë e or' e çast nuk na lë kurrë të qetë me ushtërit e tij, ashtu që na sjell dëme të mëdha në njerëz...» i shkruanin Papës së Romës fshatarët e Himarës më 12 korrik të vitit 1577, duke i kërkuar ndihma materiale dhe bekime apostolike.

Kurse në shkurtin e vitit 1581, midis të tjeravet i shkruanin: «...të na ndihmoni me një ndihmë prej tre mijë njerëz t'armatosur dhe armë për dhjetë mijë veta, më shumë veshëmbathje..... se në Himarë në një ditë mund të ngrihen dhjetë mijë burra, dhe në një javë, duke përfshirë dhe zonat kufitare, mund të ngrihen për luftë pesëdhjet mijë burra...» dhe këtë letër e nënëshkruanin krerët e këtyre fshatrave të krahinës së Himarës:

Dukat, Brogoto, Kallarat, Tërbaç, Sotirjan, Palasë, Pangalla-dhe, Dhrimadhe, Ilias, Vuno, Qeparo, Kudhës, Pilur, Kuç, Progonat, Lopës, Kastelli, Nivicë, Pijeraj, Beneci, Gorica, Kamenica, Finiqi, Daniës, Vivar, Oresta, Bafade, Terna, Zaroforicë, Lekël, Dragot, Peshtan, Gumenicë, Bernakus, Çepriot, Shën Vasili, Zhulati e tjerë..

Siq shihet në këtë letër, pra, del se cila ka qënë krahina e Himarës asokohe!

Luftrat ka qënë të pandërprrera kundër shkelësit osmanlli.

Po gjatë kësaj kohe është bërë edhe një luftë për arsim e për kulturë.

Shohim se në shekullin XVI, kur në Himarë erdhën misionarët bazilianë, fshatarët u kërkuan ndihmë që tu mësonin fëmijve të tyre shkrim e këndim. Misionarët shumica ishin arbreshë që kishin mbaruar seminaret e ndryshme ku jipej dhe gjuha shqipe. Këta misionarë qëndruan në Himarë që nga shekulli XVI e gjer në shekullin XVIII. Dhe me këmbënguljen e fshatarëve ata u ndihmuani për të çelur shkolla ku mësohej gjuha shqipe.

Shkollat e para u çelën në Dhërmi, Palasë, Vuno dhe Himarë. Këtu vinin nxënës nga Dukati, Tërbaçi, Kuçi, Lukova, Piqerasi e tjerë.

Shkollat e para i çeli Neofit Rodinoja, që besohet se në fshatrat e Himarës arriti në vitin 1632. Ky përkthente libra të vogla, i botonte me të hollat e tij dhe ua shpërndante falas fshatarëve që mësonin shkrim e këndim dhe që këndonin katekizmin shqip..

Një nga nxënësit e Rodinos ishte dhe Papa Dhimitri nga Dhërmiu, i cili, pasi ishte nga kombi shqiptar, siç thotë dhe vete Rodinoja, përktheu me një shqipe elegante katekizmin për shkollat dhe kishat e Himarës.

Pas Rodinosë, të tjerë misionarë erdhën, peshkopë dhe kryepeshkopë të cilët e vazhduan mësimin në shkollat e çelura. Nga këta më të përmëndur janë: Kostantin Onofri, Stanilas, Xhovani de Kamilis, të cilët i shtuan nxënësit, me gjithë luftën e madhe që bënte dhespoti i Janinës, i cili nuk deshte në asnjë mënyrë të mësohej shqipja, se ai ishte agjent i Fanarit që i shërbente Sulltanit duke propaganduar në kisha librat bizantine që ishin shkruar në gjuhën greke. Këta misionarë i shkruanin Papës se Himarjotët, edhe me kërcënime, kërkojnë t'i mbajnë të çelura shkollat për të mësuar fëmijët e tyre. Shkollat i mbrojnë nga sulmet e shumta të agjentëve të Fanarit dhe nga çpifjet kundër mësonjësve që japid mësim.

Bile, shkruajnë se një dhespot një ditë në Dhërmi, e kapi nga mjekra atë që meshonte shqip dhe i mallkoi djemt që mësonin shqipen.

Më vonë në Dhërmi u themelua një shkollë e vërtetë misjonare, nga duallënë nëndë priftërinj me shkollë dhe jo si ata që ishin analfabetë. Këtu shkolla merr një karakter më të gjërë, sidomos në kohën e Nilo Katalanos, i cili përpilon edhe një gramatikë shqipe dhe një fjalor italisht-shqip për nxënësit e tij që arriten gjer tetëdhjetë. Katalanoja vdiq duke shkuar për në

Korfuz, se ishte sëmurë dhe u varros në kishën e Shën Thanasit të Dhërmijut, pranë shkollës së tij. Sipas Nilo Borxhas, kjo gramatikë dhe ky fjalor ndodhen në duart e Skirojve.

Shumë prekëse janë letrat e misionarëve për dëshirën e madhe që kanë fshatarët për kulturë e për arsim. Ata shkruajnë se nxënësit e tyre mësonin në kasolle dhe konakë të varfër dhe dinin përmënç katekizmin shqip.

Lufta për këto shkolla ka qënë shumë e ashpër, se Patriku i Stambollit, me ndihmën e turqve, bëri ç'ish e mundur që të mbylleshin. Dhe një nga shkaqet e mbylljes së tyre kanë qënë luftrat e ashpra, sulmet, djegëjet, internimet si dhe largimi i misionarëve që nuk ishin më të sigurtë passi nuk pati më çaste qetësi je dhe paqeje ajo krahinë. Sulmet pirateske të turqve, rrëmbimi i fëmijëve dhe shitja e tyre si plaçkë, varfëria dhe shtypja për ta çfarosur fare atë krahinë, bënë që të mos vazhdonin më shkollat... Gjersa më von, me ndihmën e patrikut dhe të dhespotëve grekomanë, u çelen shkolla greke si në gjithë Shqipërinë e jugut — pa tjatër në fshatrat e krishterë. Këto ndodhën në fillim të shekullit XIX, kur antagonizmi midis mysylmanëve dhe të krishterëve ishte ndezur më shumë për ta përcarë popullin tonë me qëllim që të përfitonin armiqt, e veçanërisht shovenistët grekë.

Propaganda u shtua më tepër, sidomos kur Greqia fitoi independencën dhe bënte ç'ishte e mundur për t'i greqizonte ato krahina trime shqipëtare. Dhe një nga mjetet e greqizimit që ajo përdori ishte shkolla dhe feja. Po propaganda është propagandë dhe historia është histori... Krahina heroike e Himarës (domethënë Labëria e sogme) ka mbajtur në shekuj flamurin e lirisë dhe ka shkruar gjatë sundimit otoman faqe të shkëlqyera për Historinë e popullit tonë... Në këto faqe të historisë sonë të lavdishme, bëjnë pjesë dhe shkollat e para shqipe në fshatrat e Himarës.

V L O R A

E SHEKULLIT TË XV-të DHE TË XVI-të NË DISA DOKUMENTA TË HUAJA

Në kohët e fundit janë zbuluar në arkiva dhe biblioteka të jashtme shumë vepra, dokumenta dhe dorëshkrime të panjohura që flasin për vëndin tonë; midis faqeve të tyre vemi re të përmëndet edhe Vlora me rrëthin e saj.

Në qershori të vitit 1493 një udhëtar çek JAN HASISHTENSKI LOBKOVICASI kalon me det nga qarku i Vlorës, dhe e përshkruan kështu luftën e himariotëve kundër turqve, në veprën që pat shkruar disa vjet më vonë:

«Njerëzit n'atë vënd janë zotër në punën e vet, dhe s'duan t'i shtrohen kurkujt. Veten e quajnë shqiptarë. Në vendin e tyre ka plot fshatra, bagëti, drithë e verë. Kam marrë vesh gjithashtu se s'hyn dot kush në krahinën e tyre, veçse nëpër shtigje, përmes shkëmbinjsh të mëdhenj...»

Pikërisht po këta njerëz dhe banorë të kësaj krahine janë pengesa më e madhe për sultananin e Turqisë dhe për vasalët e tij.

Pastaj shkrimtari prej Lobkovice thotë se në këto anë gjejnë strehë të gjithë ata që ndiqen prej turqve, dhe se, në punë bese, shqiptari s'është fetar, por beson, si të thuash, ç'i do e bardha é zëmrës.

Duke folur për Vlorën ky udhëtar çek e quan «qytet të madh» dhe na zë në gojë kështjellën e saj.

Për këtë qytet na flet edhe një udhëtar tjetër çek: ODLRZHIH PREFATI VËLKANOVASI: ay pat kaluar s'andejmi më 1456, dhe në veprën e tij shpreh frikën që qënke përhapur n'anije se mos goditeshin prej piratësh, të cilët e paskan patur shtrofët asokohe afër qytetit të Vlorës.

Një udhëtar tjetër çek KRISTOF HARANTI prej POLZHICE lundron gjatë bregut të Vlorës më 23 korrik 1598 dhe shkruan:

...«Pamë majat e larta të Himarës, të cilat e kanë marrë këtë emër nga qyteti që shtrihet ndënë 'to».

PASQYRA E LËNDËS

Faqe-

I. VLORA FRYMËZONE:

HALIM XHELO — Atdheu	7
VELI STAFA — Vlorës	8
— Vlorës (Zani i mbrazjes)	8
PETRO MARKO — Ismail Qemalit	10
— Përmendorja e Vlorës	10
— Kënga e valës	11
ALEKS ÇAÇI — Vlonjati plak	12
ANDREA VARFI — Vlorës	13
NEXHAT HAKI — Shkëmbi im	14
— Kujtimi i shkëmbit	15

II. VLORA FRYMËZON:

NONDA BULKA — Në kryetrimen Vlorë	19
FATOS ARAPI — Vlorë, 28 Nëndor 1942	20
FERHAT ÇAKËRRI — Ballada e njëzetës	24
— Për ty Atdhe	25
— Dita e fitores	25
— U hap dhe një themel	26
DURO MUSTAFAJ — Partia	27
FETI RRAPAJ — Te varri i Ismail Qemalit	28
KUJTIM HOXHA — Vjeshtës	29
— Çfletëj albumin	30
MILIANO STEFA — Në prag të robërisë	32
— Nën fashizëm	32
— Liri popullit	33
MARO PASHO — Plakut vlonjat Ismail Qemalit	34
FERIAT BOCAJ — Natë vlonjate	36
HAMZA KOÇIU — Stuhi e detit	38
— Këndon detari	38
— Qesh vasha detare	39
— Që kurrë mos shkelet bregu yn' i lirë	40
— Buçit Fanfarë	40
PIRRO STEFA — Fjalë për vehte e për të gjithë	42

III. KUJTIME:

BEQIR VELO — Ato ditë	47
ALI ASLLANI — Sot ju flas si babagjysh	49
N. BULKA — Mexhidja e Selamit	55
SH. MUSARAJ — I vdekuri i pavdekshëm	57
Kolonel BANUSH GÇXHAJ — Këtej s'kaloni	61

IV. RAPSODI LABE:

SELIM HASAÑI — Smail Beu i varfëri	67
— Kanina nënë kala	67
— Kush e zgjoi Shqipërinë	68
— Qaj moj Vlorë rrënje-dalë	68
— Nga Sazani vjen pampori	69
— Shqipëri lule burbuqe	69
— Shqipëri moj halle madhe	70
— Shqipëri e hallev	70

V. VLORA NËPËR SHEKUJ:

P. MARKO — Shkolla shqipe në shekullin e XVI-të dhe të XVII-të	72
DHIMITËR PILIKA — Vlora e shekullit të XV-të dhe të XVI-të në disa dokumenta të huaja	75

JANE NË QARKULLIM
Letërsit Politiko-Shoqërore

		Lekë
L. Dilo	— Çerçiz Topulli me shokë	15
Vaso Boshnjaku	— Misto Mame	15
Vaso Boshnjaku	— Alqi Kondi	15
Hamit Beqja	— Revolucioni ynë kultura	20
Bejxhe Myftiu	— Hamid Shijaku	10
Ymer Minxhozi	— Ishulli kryengritës (Kuba)	20
Pipi Mitrojorgji	— Histori e shkruar me gjak	45
Izet Bajramaj	— Gana shtet i pavarrur afrikan	15
Izet Bajramaj	— Republika e Guinesë	15
— — —	— Ç'thonë amerikanët për mënyrën e jetesës amerikane	15
Irma Telman	— Ernest Telman	20
Esat Reso	— Naun Prifti (Doko)	15
Alfred Uçi	— Përbajtja dhe karakteri i epokës së sotme	15
Q. Haxhihasani	— Thimi Mitko	25
Nuçi Tira	— Zbulime në shtrofëkëm e fundit të armikut	35
Adli Dibra	— Lëvizja komuniste ndërkombëtare, forca politike më e madhe e kohës sonë	35
E.Jarosllavski	— Si lindin, jetojnë dhe vdesin përen ditë dhe perëndeshat	40
A.J. Lurie	— Komunarët e Parisit	60

Çmimi: Lekë 15